



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PARLAMENTAR
PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Dokument Parlamentar

RAPORT
MBI SHQYRTIMIN E KANDIDATURAVE PËR KRYETAR TË BORDIT TË
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE DHE PROPOZIMIN E
KANDIDATURES QË DO TË MBAJË FUNKSIONIN E KRYETARIT TE BORDIT

Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës ---.2019, organizoi seancën dëgjimore dhe seancën për shqyrtimin e kandidaturave dhe votimin e kandidaturave për Kryetar të Bordit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

Kuvendi në përputhje me afatet ligjore, shpalli për herë të parë vakancën për këtë pozicion dhe më datë 21 Janar 2019 pas përfundimit të afatit të parë të dorëzimit të kandidaturave në Kuvend u paraqitën 4 kandidatura, përkatësisht:

- Zoti Bilal Kola
- Zoti Pajtim Melani
- Zoti Olsi Çoku
- Zoti Ardit Çollaku

Pasi asnjë nga kandidaturat nuk siguroi votat e komisionit për t'ju përcjellë seancës, Kuvendi bëri shpalljen e vakancës për herë të dytë. Në datë 12 Prill përfundoi edhe afati i ri i dorëzimit të kandidaturave për vendin e kryetarit të Bordit të AMF, brenda të cilit depozituan dokumentacionin:

- 1- Zoti pajtim MELANI;
- 2- Zoti Ervin METE dhe
- 3- Zoti Olsi ÇOKU.

Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, për vlerësimin e kandidaturave, konsideroi dispozitat e Neneve 5, 6 dhe 7 të ligjit nr. 9572 datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare. Sipas nenit 6 të ligjit, Kryetari i Bordit të Autoritetit, emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, pas një procedure përzgjedhëse.

Sipas Ligjit që rregullon veprimtarinë e Autoritetit, Anëtarët e Bordit janë:

1. Shtetas shqiptarë.
2. Të ketë përfunduar ciklin e plotë të studimeve universitare në një nga këto fusha: ekonomi, juridik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve

3. Me përvojë profesionale të paktën 7- vjeçare, nga e cila, të paktën 5 vjet në njërën nga këto fusha ose në disa prej tyre të marra së bashku:

- a) financë-kontabilitet;
- b) administrim i shoqërive tregtare;
- c) këshillim ligjor i shoqërive tregtare;
- ç) hartim legjislativ;
- d) shkencë e aktuarëve;
- dh) sigurime shoqërore dhe pensione.

4. Me integritet moral dhe profesional.

5. Të paangazhuar në funksione drejtuese partiake.

6. Të pashpallur si të dënuar penalisht, me vendim gjykatë të formës së prerë.

Në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për konfliktin e interesave, nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Autoritetit persona, të cilët:

- a) në tre vitet e fundit kanë qenë ortakë, aksionarë, apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të mbikëqyrura;
- b) kanë lidhje familjare me personat e parashikuar në shkronjën “a”;
- c) në tre vitet e fundit kanë qenë punonjës me kohë të pjesshme apo të plotë në subjektet e mbikëqyrura.

Çdo anëtar i Bordit, në vijim, ka detyrimin të deklarojë përpara Kryetarit të Kuvendit, në lidhje me rrethanat e parashikuara më sipër.

Anëtarët e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mund të rizgjidhen për një mandat të dytë pas përfundimit të mandatit të tyre.

Gjatë seancës dëgjimore të datës 17 prill 2019, kandidaturat u prezantuan dhe ju përgjigjën pyetjeve të Deputetëve.

Deputetët vlerësuan maksimalisht të gjitha kandidaturat. Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave vlerësoi që në Kuvend po prezantohen kandidatura cilësore dhe me integritet profesional.

Në përfundim të votimit dhe vlerësimit për të gjithë kandidatët, me votën pro të deputetëve të maxhorancës dhe abstenimin e deputetit të opozitës, u vendos që të tre kandidaturat t'i përcillen për votim dhe vendimmarrje përfundimtare seancës plenare, me sugjerimin që të mbështetet kandidatura e Ervin METES.

Kryetar
Arben Ahmetaj